

# YAHR: Lipjani rrit të hyrat nga qiraja - zvogëlon shpenzimet

Arian Duriqi

LIPJAN, 12 QERSHOR – Shoqëria civile në Lipjan, përkatësisht Youth Association for Human Rights (YAHR), në raportin monitorues për 6-mujorin e parë të këtij viti ka evidencuar se pushteti i ri në Lipjan ka pasur rritje të të hyrave dhe zvogëlim shpenzimesh. Në të vërtetë, Komuna e Lipjanit qysh në tremujorin e parë të këtij viti kishte arritur të ulë shpenzimet e derivateve në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, ndërsa ka rritur të hyrat nga tatimi në pronë dhe nga qiraja e objekteve komunale. Sipas shifrave zyrtare që ka ofruar, ndërkaq, Drejtoria e Buxhetit dhe e Financave në Lipjan thuhet se shpenzimet e derivateve janë ulur për 31.7 për qind më pak sesa në vitin e kaluar. Edhe YAHR, ndërkaq, po vlerëson se ka pasur reduktim shpenzimesh të derivateve të naftës, reduktim shpenzimesh administrative dhe vendosje të arkave fiskale nëpër punktet administrative. Sidoqoftë, Bekim Krasniqi, drejtor ekzekutiv në YAHR, ka vlerësuar po ashtu se qeverisja në Komunën e Lipjanit gjatë periudhës janar - qershor 2014 është përballur me shumë vështirësi në realizimin e projekteve të planifikuara me buxhet për vitin 2014. “Deri në muajin maj 2014, nuk kemi pasur asnjë projekt kapital të filluar për realizim. Përveç këtyre, ekzekutivi i ri ka trashëguar projekte të papërfunduara gjatë viteve të kaluara dhe më këtë edhe obligime ndaj kontraktuesve në vlerë afro 7.2 milionë euro, të cilat e kanë vështirësuar punën në menaxhimin sa më të mirë të parasë publike. Por, megjithatë, ekzekutivi i Komunës së



**Bekim Krasniqi, drejtor ekzekutiv në YAHR, ka vlerësuar po ashtu se qeverisja në Komunën e Lipjanit gjatë periudhës janar - qershor 2014 është përballur me shumë vështirësi në realizimin e projekteve të planifikuara me buxhet për vitin 2014**

Lipjanit ka pasur disa lëvizje pozitive, siç është heqja e taksave komunale për biznese, reduktimin e shpenzimeve të derivateve të naftës, reduktimin e shpenzimeve administrative dhe vendosjen e arkave fiskale nëpër punktet administrative”, ka thënë Krasniqi. Kohë më parë, ndërkaq, ka qenë edhe Shkëlzen Hajdini, drejtor i Buxhetit dhe Financave, që ka deklaruar se që nga instalimi i pushtetit të ri në këtë komunë ka pasur ndryshime në punë dhe në shpenzime. Sipas tij, shifrat kanë ndryshuar në favor të Komunës në pjesën e parë të këtij viti, për faktin se, siç ka thënë ai, është rritur edhe kontrolli.

“Shifrat që janë kthyer në favorin e Komunës janë rezultat i një pune më të madhe në krahasim me menaxhimin e kaluar. Kemi shtuar

përgjegjshmërinë në shpenzime derivate dhe janë ulur ato shpenzime, ndërsa kemi shtuar kontrollin të qiraja komunale, ndërsa edhe aty janë rritur të hyrat në shkallën e kënaqshme”, ka thënë ai.

Megjithatë, opozita në këtë komunë po vlerësonte njëherësh se Komuna nuk mund të krenohet vetëm me të dhëna në vija të trasha nga të hyrat nga qiraja dhe të tjera, por që nevojiten hapa konkretë për transparencë më të madhe në këtë plan. Lulzim Rustemi, nënkryetar i PDK-së, Dega e Lipjanit, ka ripërsëritur qëndrimin e këtij subjekti se pushteti lokal po mundohet që nëpërmjet këtyre të dhënave për qiratë dhe tatimet në pronë të maskojë premtimet e dhëna në fushatë.

© KOHA Ditore